

VENDIM
Nr. 665, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 491, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKINË KURBIN, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në qytetin e Laçit, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në masën 53 118 160 (pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.”;

b) Në pikën 3 fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku